

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

8SH-1  
K 14

BIBLIOTEKA E NXËNËSIT

SMAIL KADARE

PRINGESHA

ARGJIRO



SHTËPIA BOTUESE E LIBRIT SHKOLLOR


TIRANË, 1977

BIBLIOTEKA E NXËNËSIT

ISMAIL KADARE

# PRINCESHA ARGJIRO

POEMË



12881

SHËTËPIA BOTUESE E LIBRIT SHKOLLOR  
TIRANË, 1977

## Dy fjalë

Shkrimtari Ismail Kadare ka lindur në qytetin e Gjirokastrës në vitin 1936. Mbaroi shkollën fillore dhe të mesme në qytetin e lindjes.

Studimet universitare për letërsi i ndoqi në Tiranë dhe pastaj jashtë shtetit.

Ismail Kadareja ka shkruar shumë libra: vëllime me poezi dhe romane.

Ka shkruar edhe për fëmijë, si poemat «Princesha Argjirro», «Gurghendësit» etj.

Ai ka marrë tri çmime të Republikës.

Është anëtar i Kryesisë së Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve të Shqipërisë dhe deputet në Kuvendin Popullor të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë

## Përmbajtja e poemës

Princesha Argjiro, një grua trime, e zgjuar dhe e vendosur, drejton luftëtarët shqiptarë të kështjellës.

Burri i saj, një luftëtar trim, është vrarë për atdheun.

Ajo ka një djalë të vogël. I këndon djalit këngë trimërie dhe, si gjithë nënat shqiptare, dëshiron që i biri i saj të bëhet trim e luftëtar i pamposhtur për mbrojtjen e atdheut.

\*  
\*      \*

Nga larg vjen me shpejtësi një kalorës i plagosur. Ai kërkon të takohet me princeshën Argjiro, të cilën e njofton se po afrohet një ushtri e madhe turke.

Në kështjellë fillojnë përgatitjet për luftë.

Në të njëjtën kohë, lajmërohen banorët e fshatrave të afërta e të largëta për t'u përgatitur.

\*  
\*      \*

Si kurdoherë, trimat shqiptarë, njëzëri, shprehën gatishmërinë e tyre për të luftuar armiqtë. Liria për shqiptarët është gjëja më e çmuar. Ata janë gati të japin edhe jetën për lirinë e shtrenjtë.

Fillon lufta. Një luftë e pabarabartë.

Turqit tmerrohen nga qëndrimi i vendosur i shqiptarëve. Pas çdo përpjekjeje, qindra turq lënë kockat rreth e qark kështjellës.

Kështjella qëndron e pamposhtur. Në kullën më të lartë valon krenar flamuri shqiptar.

\*  
\*   \*  
\*

Po ç'ndodh një natë?

Qeni i pabesë, tradhtari i urryer Disdar Galopi, fshehurazi, zbret nga kulla dhe shkon në kampin turk. Ai u tregon armiqve shtegun e fshehtë nga mund të hyhet në kështjellë. Armiqtë hyjnë nga ky shteg.

Roja jep alarmin. Pabesi! Tradhti!

Beteja të përgjakshme zhvillohen trup me trup brenda në kështjellë.

Argjiroja lufton me trimëri. Kur sheh se vriten edhe rojet e fundit të kështjellës, merr djalin dhe së bashku me të hidhet në humnerë, për të mos rënë në duart e armikut.

\*  
\*   \*  
\*


Kështjella ra me tradhti, por shqiptarët e vazhduan luftën kundër turqve më me trimëri, më me ashpërsi dhe më me vendosmëri.

---

### Shpjegim

Ngjarja e poemës «Princesha Argjiro» zhvillohet në kështjellën e qytetit të Gjirokastrës.

Qyteti i Gjirokastrës sot është shpallur qytet-muze dhe në kalanë e tij është ngritur muzeumi Kombëtar i Armëve.



## I

Ti akoma nuk e di  
se ka një qytet në Jug,  
me oxhakë e me çati,  
me shtëpi, përrenj e rrugë.

Ngjan ai me një shqiponjë,  
që u gatit të fluturojë,  
por në çastin më të fundit  
ndërroi mendje e krahët shkundi  
dhe i hapi përmbi brigje,  
ura, rrugë, qoshe e shtigje.

Përmbi supe ç'mbajnë vallë  
këto gërxhe radhë-radhë?

Një kala e lartë,  
si një vapor lufte,  
noton ditë e natë  
mes shekujve tutje.

Si anije e zezë,  
që pushon në rërë,  
ngjan tani fortesa  
e heshtur, e vrërët.

Dhe vërtet ka kohë shumë  
që ka rënë ajo në gjumë.

Gryka topash janë ndryshkur  
e bedenat janë prishur  
dhe në kulla e sharapolle  
s'ka më roje, karakolle.

- 
- poemë-a* — vepër pak a shumë e gjatë e shkruar në vargje  
*shteg-u* — rrugë e ngushtë në mal, vendkalim i ngushtë  
*breg-u* — brigje — këtu: kodër e vogël  
*qoshe-ja* — kënd, anë  
*fortesë-a* — kala  
*gërxh-i* — vend shkëmbor  
*i vrërët* — i vrenjtur, i ngrysur, jo i qeshur  
*beden-i* — pjesa e sipërme dhëmbë-dhëmbë e mureve të trasha  
të kështjellës, që shërben për mbrojtje  
*sharapoll-i* — një pjesë e dalë në këndin e anës së përparme të  
kështjellës, e pajisur me kamare (vend i hapur në mur), që  
shërben për mbrojtje  
*karakoll-i* — vendi ku qëndron roja, postroje; roja vetë


### **Ç'kuptoni me fjalët:**

- Përmbi supe ç'mbajnë vallë këto gërxe radhë-radhë?
- Dhe vërtet ka kohë shumë që ka rënë ajo në gjumë. . ?

### **Pyetje e detyra**

- Për cilin qytet flitet?
- Ku është ndërtuar qyteti i Gjirokastrës?
- Meqenëse qyteti është ndërtuar në lartësi, me cilin shpend e krahason poeti? Gjeni krahasimin në libër.
- Ç'krahasim është përdorur për kalanë e këtij qyteti?
- Lexoni vargjet ku tregohet se dikur në këtë kala janë bërë luftime të ashpra.






## II

Ky qytet me ura, kthesa,  
ky qytet i gurtë, i pastër,  
siç e ke ti vajzë, një emër,  
e ka emrin Gjirokastër.

Pas ca kohe e pas ca vitesh,  
vajzë e vogël, kur të rritesh,  
do të marr unë ty për dore,  
do të shkojmë atje larg,  
te kështjella mbi bregore  
do të çlodhemi ne pak.  
Dhe siç zbresim në bodrume,  
thellë shekujve do të zbresim,  
me bori e me dum-dume  
kohrat do të na përshëndesin.

Jepma dorën. Eja, eja!  
Është ftohtë, lagështirë?  
Mos ki frikë! Pa vër veshin  
dhe hidh sytë në errësirë.  
A nuk ndien si rend me shpatë  
një kalorës nëpër natë?



### III

Fushës së errësuar  
vallë ç'është ai?  
Një kalorës kalin  
e nget si veri.

Shpata seç i varet,  
gjaku ç'i kullon.  
Natë e zezë tutje  
nxin porsi një hon.

Vrapon buzë lumit,  
era pas e ndjek,  
çohet si në pritë  
në të errët një shelg.

{ Vetëtimë e shpejtë  
si mendimi ndrin,  
pastaj prapë rruga,  
rrugë e largët nxin.

Rruga me patkonjtë  
grindet përsëri.  
Rruga pyet patkojtë:  
«Vallë ç'është ky?»

Por për bisedime  
patkonjtë s'kanë nge.  
Ikin posi era,  
shkrepin si rrufe.

Xhadeja me erë,  
shkëndija potkonjsh.  
Nga kulla flet roja;  
«Kush kalon përposh?»



#### IV

Që nga poshtë një zë thirri:  
«Jam një lajmës nga kufiri.»

U hap porta me ngadalë,  
kërcitën fletët e rënda  
dhe kalorësi pa fjalë,  
dyll i verdhë hyri brënda.

Gjak i kuq skuq në gjymtyrë,  
lajm i zi nxin në fytyrë.  
«Shpjermëni — tha — sa më parë,  
te princesha, o ushtarë.»

---

*hon-i* — greminë, humnerë  
*pritë-a* — të ndenjurit fshehur për të zënë në befasi dikë, (kë-  
tu: pengesë)  
*rhade-ja* — rrugë e madhe, e gjerë

#### Ç'kuptoni me fjalët:

- e nget si veri . . . .
- era pas e ndjek . . . ?

#### Pyetje e detyra

- Me kë njiheni në këngën e tretë?
- Ç'mësuat për kalorësin?
- Pse shkrimtari thotë: «lajm i zi nxin në fytyrë»?  
Ç'do të tregojë ai me këto fjalë?
- Gjeni pesë krahasimet që përdoren në këngën e tretë:  
si:  
si:  
si:  
si:  
si:  
• Vini një titull për këngën e katërt.




## V

Princesha nuk kishte rënë,  
princesha nuk kishte fjetur.  
Ballin e bukur si hënë  
te djepi e kish mbështetur.

Kjo ish Argjiroja krenare,  
që kur burri i kish vdekur  
armët e tij kishte marrë,  
shpatë dhe parzmorë të hekurt.

Tani që nëpër bedenë  
rojet heshtur vijnë e venë,  
kryqëzojnë shtizat heshtur,  
ndihet kënga e princeshës:



## VI

«Fli, o bir i nënës,  
nina-nana, fli,  
rrugët i zuri gjumi  
dhe fusha u nxi.

Djepi yt i vogël  
sonte po kërcet.  
Të pret ty parzmorja  
dhe shpata të pret.



Ati yt i dashur  
nën dhé po fle,  
dhe një lis i lartë  
tundet përmbi të.

Mbi lisin e lartë  
zogjtë për çdo mot  
e thërresin të ngrihet,  
po nuk ngrihet dot.

Natë e zezë, e dendur,  
rreth e rrotull ra,  
po nuk flenë ushtarët,  
biro, në kala.

Kullat janë të larta  
muret me qemer,  
heshtat kryqëzojnë  
rojet nëpër terr.

Fli, o bir i nënës,  
nina nana, fli.  
Rrugët i zuri gjumi  
dhe fusha u nxi.

---


*parzmore-ja* — këmishë e hekurt që vishnin luftëtarët në kohët  
e lashta

*shtizë-a* — heshtë, armë për sulm me bisht të gjatë e me majë  
të hekurt

*qemer-i* — pjesa prej guri në formë si të rrumbullakët e dyerve  
të shtëpive të vjetra ose të kështjellave

### Ç'kuptoni me fjalët:

- Tani që nëpër bedenë  
rojet heshtur vijnë e venë,  
kryqëzojnë shtizat heshtur...



- Të pret ty parzmorja  
dhe shpata të pret...?

### Pyetje e detyra

- Ç'bëri Argjiroja pasi i vdiq i shoqi? Ç'tregon ajo?
- Kujtoni ndonjë tregim që keni lexuar për qëndrimin heroik të gruas shqiptare.

- Populli ynë thotë:

«Trimëria merr kala,  
vigjilenca fort e mban»

Ku e dalloni këtë në këngën e pestë e të gjashtë? (Lexoni vargjet ku tregohet si ruhej kështjella.)

- Argjiroja nënë i këndon fëmijës para se të flejë. Çfarë i thotë ajo? Ç'dëshiron t'i bëhet djali?

- Si i kuptoni fjalët: «Te ne sot të gjithë janë ushtarë?»



## VII

E çuditshme dhe e rëndë  
ty kjo këngë ndoshta të duket.  
Mami yt të tjera këngë  
të këndon mbrëmjes, pas buke.

Por ajo ish kohë e rreptë  
me fortesa përmbi brigje.  
Pirgjet dukeshin si retë,  
retë dukeshin si pirgje.

Shpesh qëllon këngën e mamit  
telefoni e ndërpret.  
Po të tmerrshmin bri alarmi  
a e di ti si buçet?

Ja, një bri i tillë i tmerrshëm  
preu natën mes për mes.  
E ndërpreu këngën princesha,  
djepin la dhe mbajti vesh.

Briri i rojes në errësi  
prapë ra atje përposh.  
Nata dridhej dhe mënxyrën  
briri i natës po ia thosh:

«Ty ty ty,  
lini shtratet.  
Kapni shqytet  
dhe shpatat.

Lini gjumin  
dhe ëndrrat.  
Kapni heshtat.  
e rënda.

Ty ty ty,  
nxirrni topat.  
Erdh armiku  
tek portat.



## VIII

Te princesha i plagosur,  
flokëprishur, gjakdamkosur,  
lajmëtari brënda hyri.  
«Turqit po sulmojnë» — thirri.  
Edhe ra në dhe pa frymë,  
siç bie lulja nën brymë.

Ndërkaq, kështjella u zgjua,  
u ndezën kudo pishtarë.  
Bedenat zienin si zgjua  
nga britma, zëra, ushtarë.

Ja tani tundeshin zjarret  
majë kullave si xhufka,  
dhe fshatarë e qytetarë  
morën vesh se nisi lufta.



**brir-i** — mjet i bërë nga brirët e kafshëve, me anën e të cilit jepej alarmi atëherë kur mungonin mjetet që kemi sot.  
**mbajti vesh** — dëgjoj  
**shqyt-i** — mburojë, armë që mbahej në krahun e majtë, për të mbrojtur kokën dhe krahërorin  
**mënxyrë-a** — fatkeqësi  
**gjakdamkosur** — me njolla gjaku  
**brymë-a** — vesë e ngrirë  
**pishtar-i** — pishë e ndezur, e vënë mbi një dru ose pjesë metalike

### Ç'kuptoni me fjalët:

- Lini gjumin dhe ëndrrat.  
Kapni heshtat e rënda.

### Pyetje

- Pse princesha e ndërpreu këngën që i këndonte djalit?
- Ç'lajm të keq solli kalorësi i plagosur?
- Ku e dalloni atdhedashurinë e tij?
- Ç'ndodhi në kështjellë pasi u përhap lajmi? Vini re përshkrimin që bën poeti në këto vargje:  
 «Ndërkaq, kështjella u zgjua,  
 u ndezën kudo pishtarë,  
 bedenat zienin si zgjua  
 nga britma, zëra, ushtarë»



## IX

«Ç'është lufta? do të pyesësh,  
luftën fare ti s'e di.  
Veç dy herë ti je përleshur  
me macen lëkurëgri.



Ti s'ke parë ushtritë  
kur qëndrojnë ballë për ballë,  
me topa, mushka dhe tyta,  
flamurë, parzmore e pallë.

Dhe s'gërvishtin në fytyrë  
si macja lëkurëgri,  
por hapin plagë mënxyrë,  
derdhin gjak të kuq, të zi.

Derdhen trimat si luanë,  
derdhen armiqtë si tigrat ...  
Mbulohet fusha e paanë  
nga varret, gurët e hithrat.

## X

Kur agoi mëngjesi i thellë,  
u vërsulën për kështjellë  
qytetarë e katundarë,  
festebardhë, gunëlarë.

Që nga kulla e kalasë  
përtej fushës së pamasë  
me dylbi vështronin rojet  
stanet, xhadetë dhe krojet.  
Vështronin tutje në jug  
mos ngrihej pluhur në rrugë.

Por më kot së mbrëmja iku  
dhe s'u duk gjëkund armiku.  
Veç kur muzgu ra dhe mbrëmja,  
një daulle ra si gjëma,  
dhe pas pluhurit në erë  
varg u dukën këtë herë,  
si ciklon, si re e zezë,  
turqit rrëzë kallamesë.  
Thirrën gjithë: «Ja, po vijnë,  
si skëterra fushës nxijnë.»

---

*festebardhë* — me kësulë të bardhë prej leshi, me qeleshe  
*gunë-a* — veshje e barinjve që hidhet krahëve për t'u mbrojtur  
nga të ftohtët e nga shiu. Është e trashë, e bërë me lesh  
dhie dhe ka një kapuç.

*ciklon-i* — erë e tmerrshme që kalon me shpejtësi të madhe  
*ra si gjëma* — u përhap si një lajm i keq

*kallame-ja* — arë me kërcejtë e prerë të misrit e të grurit, që  
mbeten në tokë pas korrjes

*si skëterra* — këtu: si errësira

### **Ç'kuptoni me fjalët:**

- Kur agoi mëngjesi i thellë;
- Ja, po vijnë, si skëterra fushës nxijnë... ?

### **Pyetje e detyra**

- Ç'bënë fshatarët dhe qytetarët porsa panë zjarret e ndezura?
- Po rojet e kështjellës?
- Lexoni vargjet ku dalloni se armiqtë ishin të shumtë.



## XI

Dhe doli princesha vetë,  
vështroi fushën, vështroi retë.  
Princesha ndreqi shaminë:  
«Në vijnë, mirë se të vijnë,  
te vdekja e tyre po vijnë.»

Nga bedeni më i lartë  
ajo vështron. Dritëartë  
hëna ndrin e bukur shumë  
mbi livadhe e mbi lumë,  
që rrjedh valëturbulluar,  
duke klithur e gjëmuar.

Rend e ikën tatëpjetë,  
Në ujët e tij të zbetë  
pasqyrohen shtiza, shpata,  
kuaj, topa dhe sëpata.  
Ndanë tij ecin në të errët  
me flamurë jeniçerët.

I sheh princesha tek vijnë  
si ylli që sheh stuhinë.

---


*livadh-i* — luadh, tokë me bar që shërben si kullotë për bagëti  
*duke klithur e gjëmuar* — këtu: duke bërë zhurmë

### Ç'kuptoni me fjalët:

- Në vijnë, mirë se të vijnë,  
te vdekja e tyre po vijnë.»?

### Pyetje

- Tregoni me fjalët tuaja si e përshkruan poeti natyrën atë  
mbrëmje kur erdhën jeniçerët.
- Me ç'armë ishin pajisur jeniçerët?
- Pse është përdorur fjala «stuhi»? Çfarë do të krahasojë  
poeti me stuhinë?
- Për se flitet në këtë këngë?



## XII

Hesht kalaja hijerëndë  
nën hënën e argjëndtë.  
Veç flamuri po rreh palët,  
porsi deti që s'rresht valët.

Veç së largu sjell thëllimi  
zhurma të egëra marshimi,  
trokun e kuajve armikë,

tinguj dajresh e muzikë,  
që shpërndahen nëpër natë  
si vajtim e si mandatë:

«Allah, allah,  
me ditë e muaj  
çajmë përmes  
tokën e huaj.

Shkon jeniçeri  
karvan karvan,  
në dorë shpatën  
dhe një kuran.

Atje ku shkelin  
nuk mbin më bar.  
Mbin vetëm vdekja  
me kryq e varr.

Shiu na rreh  
vdekja na merr

.....

.....

Jona do bëhet  
gjithë kjo dynja ...  
ecim përpara  
allah, allah».

---

*hijerëndë* — madhështore

*thëllim-i* — erë e ftohtë

*trok-u* — ecje e kalit gati me vrap

*mandatë-a* — lajm i keq

*allah-u* — Me këtë fjalë turqit i drejtoheshin zotit të tyre që mendonin se ekzistonte. Në këtë rast, ata e bëjnë këtë nga

dëshpërimi, se e shikojnë që shumë nga ata po vriten në luftë larg vendit të tyre.

*kuran-i* — libër fetar


**Ç'kuptoni me fjalët:**

- hesht kalaja hijerëndë;
- flamuri rreh palët ... ?

**Pyetje**

- Për se shkrimtari, para së gjithash, përshkruan flamurin që valvitet mbi kështjellë?
- Në ç'mënyrë paralajmërohet ardhja e një ushtrie të madhe armike?
- Ç'krahasime ka përdorur shkrimtari në këtë këngë?
- Ç'titull mund t'i vini këngës së 11-të dhe të 12-të të marra së bashku?





### XIII

U gdhi dita, iku nata.  
Nga bedenat rojet panë:

nga çdo anë qindra çadra  
kishin rrethuar kalanë.

Vajzë, tani do të tregoj,  
ç'do të thotë në luftë rrethim.  
Në plazh, të dielën që shkoi,  
i pe çadrat pambarim?

Ja kështu rrotull fortesës  
mbijnë çadrat si kërpudha:  
ca të bardha, ca të zeza,  
tek ura, te kroi, tek udha.

Por nuk janë çadra vere  
këto kërpudha me helm.  
Ndihen britma jeniçerësh

.....

Porsi shtrigat këto çadra  
duan të mbytin kalanë.  
Dhe gurët dogjën në ara,  
dhe ujin në kroje e thanë.

XIII



#### XIV

Luftë. S'ndihen këngë zogjsh.  
Tym e mjegull anëmbanë.  
Ditë e natë, ç'të dëgjosh?  
Grinden topat me kalanë.

«Dorëzohu!» thonë topat.  
Predhat varg kafshojnë muret,  
po kalaja s'e ul kokën,  
kullat valvitin flamuret.

Dhe vazhdon kjo grindje e rëndë,  
jo me fjalë, por me gjyle,  
se kalaja hijerëndë  
topit me top i përgjigjet.

Del princesha tek ushtarët,  
kontrollon edhe jep urdhër,  
Dikush zift zien në kazanët,  
dikush shpatën rreh në kudhër.

Netëve shkëlqejnë zjarre  
dhe kasollet katundare  
si qirinj po digjen tutje.  
Plakat bëjnë kryq e lutje.

Mbi bedena te fortesa  
gra dhe vajza shamizeza  
kanë dalë e po vështrojnë  
turqit vendin si shkretëojnë.

---

*kudhër-a* — një pjesë çeliku, mbi të cilën kovaçi rreh hekurin  
e skuqur.

*shkretëoj* — shkatërroj një vend, e bëj të shkretë.

### **Ç'kuptoni me fjalët:**

- Predhat varg kafshojnë muret,  
po kalaja s'e ul kokën . . . ?

### **Pyetje e detyra**

- Tregoni si përshkruhet lufta në këngën e 13-të dhe të 14-të.
- Lexoni vargjet ku del qëndrimi i papërkulur i shqiptarëve.
- Ku e kuptoni shqetësimin e grave dhe të vajzave?
- Si paraqitet princesha Argjiro në këtë këngë?

## XV

Çadra dhe çadra.  
Trishtim, mërzi.  
Malet u thinjën,  
bora u nxi.


E zhveshur fusha  
nga era ngjethet.  
Dridhet sikur  
e zënë ethet.

Duajt e grurit  
në arë u thanë  
porsi jetimë  
shtrirë anembanë.

Ikën dhe zogjtë,  
rosa, lejlekë,  
pamëndë e drunjtë  
kalbet në pellg.

Udhës së shkretë  
me kalë te çadrat  
një jeniçer  
bredh me të katra.

Toka për buajt  
mban zi. I flihet.  
Një dajre e huaj  
netëve ndihet.



## XVI

Argjiro, bijë e kalave,  
kullat në gjak seç i lave.  
Duro gjyle e top duro,  
mbani pirgje, mure mbani.  
Gurët u nxinë kudo  
nga zjarri dhe nga katrani.

Porsa yjet rrallësojnë,  
zënë portat e rënkojnë.  
Buçasin brirët në kulla

për në sulm thërret daullja.

Derdhen turqit radhë-radhë;  
mbi kokë u bie katrani.  
Shtrirë mbi shkëmbinjtë e bardhë  
nxijnë e duken si shëjtani.

Vajzë, rrugët i ke parë?  
Janë të shtruara me asfalt.  
Por në kohërat e para  
asfaltin hidhnin që lart.  
Asfalti i nxehtë kullonte,  
digjte, shtrinte njerëz përdhe.  
Përmbi trupat mund të shkonte  
një qerre si mbi xhade.

Duro gjylet e rrufetë,  
kala me kokën te retë.  
Mbi shkëmbinjtë e tu të nxirë  
jeniçerët janë shtrirë.

Thyer shpata, jataganë,  
korbat sytë po u hanë.

#### Ç'kuptoni me fjalët:

- Argjiro, bijë e kalave,  
kullat në gjak seç i lave;
- Kalaja me kokën te retë... ?
- Nga lufta vendi u shkretua. Toka mbeti pa punuar.  
Në këngën e 15-të lexoni pjesën ku paraqitet kjo gjendje.
- Si del Argjiroja? Thoni cilësitë e saj.
- Tregoni me fjalët tuaja një çast beteje. Kini parasysh të  
flitni për qëndrimin e shqiptarëve në kështjellë dhe për turqit  
që janë aty pranë.
  - Lexoni vargjet ku del shkatërrimi i armikut.
  - Ç'cilësi e lartë e luftëtarëve shqiptarë del në këtë pjesë?
  - Duke kujtuar ato tregime apo pëezi që keni lexuar për  
Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, flitni për qëndrimin he-  
roik të partizanëve tanë trima.
  - Partia edukon te njerëzit tanë virtytet e larta (vetitë e  
larta) të popullit. Thoni disa prej tyre, që i dalloni në këtë poe-  
më.



## XVII

Natë. Malet kanë rënë  
në mendime. Disa flënë.  
Vetëm retë mbi fortesë  
udhëtojnë me përtesë.



Qielli i zbrazur krejt nga zogjtë  
vështron dheun si i vrarë.  
Hënë e verdhë ndriçon poshtë,  
u rrëfen reve të vrarët.

Retë ecin e vështrojnë,  
nisin lotët t'u pikojnë.

Shi. Po flë kala e fortë.  
karakolli rri në portë.

Po më tutje në një kullë  
një njeri i vrenjtur rri.  
Thith e thith të gjatën llullë,  
vështron natën që u nxi.

Oficer i Argjirosë,  
vallë pse po rri brengosur?  
Si shkëlqimet e rrufeve,  
që dredhojnë midis reve,  
ashtu shpejt ndër mend i vijnë  
mendime e pamje që nxijnë.

Vallë ç'ka Disdar Galopi,  
syqifti, mustaqekorbi?

Nderin mos ia kanë marrë,  
rrogën mos s'ia kanë dhënë;  
miku mos i është vrarë,  
në shesh të luftës ka rënë?

Pse këndon tek rri i ngrysur  
posi qiell i përmbysur?

## XVIII

Ja, tani erdhi koha,  
princeshë.  
Skllavja ime tani  
do të jesh.

Unë te turqit do të shkoj  
natës së thellë  
dhe një shteg do t'u tregoj  
për në kështjellë.

Do të kërkoj nga ata  
si shpërblime  
që të bëhesh ti  
skllavja ime.

- 
- i brengosur* — i hidhëruar, i mërzitur  
*qift-i (syqift)* — zog grabitqar (ka shikim të keq, shikim prej grabitqari)  
*mustaqekorb* — mustaqezi, me mustaqe të zeza si pendët e korbit  
*i ngrysur* — i vrenjtur, jo i qeshur  
*skllave-skllavja* — njeri që nuk gëzon të drejta, që jeton i shtypur

### Ç'kuptoni me fjalët:

- vështron natën që u nxi...
- mendime e plane që nxijnë...
- Prapa shpine dikur seç i shtiva...?

### Pyetje e detyra

- *Ç'mësuat për Disdar Galopin?*
- *Nga cilat fjalë kuptoni se ky është njeri i keq?*
- *Radhitni mbiemra që tregojnë se si është Disdar Galopi.*

## XIX

Erë e fushës po sjell zvarë  
një tjetër këngë që larg.  
Një këngë e lodhur ushtarësh  
natës po i lind në bark.

Është këngë e zyrtë turqish,  
mbushur me mërzi e shi,  
Anadulli mbeti tutje,  
si s'ke fund, moj Rumeli!

«Natë e zezë plot me re,  
tokë e huaj.  
Në fushim po rrimë ne,  
rojet ruajnë.

Ndritin jataganët rreth  
ndanë zjarreve.  
Kënga natën seç e ngjeth  
e ushtarëve.

Larg në Lindje, në Turqi,  
tutje fshatrave,  
presin krojet në qetësi,  
hiri i vatrave.

Lodhur hëna mbi katund  
prej mendimeve.  
Rruga për atje s'ka fund,  
mes marshimeve.

Do të vijmë vallë atje,  
gjirit tuaj?


Natë e zezë plot me re,  
tokë e huaj.

---

*fushim-i* — qëndrimi i një ushtrie nëpër çadra  
*jatagan-i* — një lloj shpate me një presë me majë të kthyer e  
me dorezë të stolisur

### Pyetje e detyra

- Ç'po bënin ushtarët turq në kampin e tyre atë natë me re?
- Nga cilat fjalë kuptoni se ushtarët turq janë të detyruar, kundër dëshirës së tyre, të luftojnë për sulltanin? Lexoni vargjet.
- Pse lufta e shqiptarëve kundër turqve është luftë e drejtë, ndërsa lufta e turqve kundër shqiptarëve është e padrejtë?
- Vini re se si poeti, krahas trishtimit që ka pushtuar ushtrinë turke, paraqet dhe natyrën të trishtuar.



## XX

Era frynte përmbi dhe,  
grykat i linte pa gjumë.  
Natë e vjeshtës plot me re  
botën e mbuloi si gunë.

O ju re, që po lëvrini,  
hënën sonte pse e fshihni?  
Hënës hapini një udhë


të ndriçojë në atë kullë,  
ku u hodh mbi shkëmb të ashpër  
një litar porsi një gjarpër.

Me litar zuri të zbresë  
një njeri midis shkëmbinjve.  
Dil, moj hënëz e pabesë,  
hënë e ngrënë e osmanllinjve.

Po kjo hënë, gjysmëhënë,  
s'e ndihmon, jo, vendin tënë.  
Tatëpjetë vrapon Disdari,  
ikën, zvariset përdhe.  
I ndien hapat e tradhtarit  
si gjëmojnë larg atje?

Grap e grup në pellg e tragë,  
nëpër shteg, nëpër zabel.  
Edhe tokës i hap plagë  
thundër e rëndë, tek e shkel.

Vaje dhe mallëkime nënash  
nxjerr çdo gozhdë e tij, çdo hap.  
Kufoma, klithma dhe nëma  
pas e ndjekin në atë vrap.



## XXI

Natë. Po në bark  
nata ç'do të ketë?  
Një karvan lëviz  
si bullar përpjetë.

Turqit varg e varg  
futen në kështjellë  
nga një derë e vogël,  
nga një shteg i thellë.

Tradhëtari rri  
tani nën ullinjtë,  
në natën që nxin  
numëron flarinjtë.

Çdo flori i tij  
është një kokë e therur.  
Një fytyrë të vdekuri  
çdo flori i verdhë.

Tek i numëron  
aty nën ullinjtë,  
me një qeshje vdekjeje  
ngërdheshen flarinjtë.

---

*lëvri* — lëviz shpejt  
*bullar-i* — një lloj gjarpri  
*osmallinjtë* — turqit  
*tragë-a* — gjurmë  
*zabel-i* — pyll i vogël për të prerë dru

#### Ç'kuptoni me fjalët:

- hënëzës hapini udhë  
të ndriçojë në atë kullë... ?

#### Pyetje

- *Pse tradhëtari Disdar Galopi zgjodhi natën pa hënë për të plotësuar qëllimin e tij.*
- *Vini re si e krahason poeti hënëën që nuk qe e plotë me hënëën e flamurit të osmanllinjve.*
- *Si veproi ai që të mos diktohej nga rojet e kështjellës?*
- *Ç'duhet t'i ketë thënë sulltanit? Si e shpërbleu ai?*
- *Nga hynë armiqtë në kështjellë?*
- *Pse e urreni Disdar Galopin?*



## XXII

Princesha ende s'kish rënë,  
princesha nuk kishte fjetur.  
Ballin e bukur si hënë  
te djepi e kish mbështetur.

Në ballin e saj dy rrudha  
alarmet i kishin vënë,  
zjarret e natës mbi kulla,  
varret, uria, të rënë.

«Fli, o bir i nënës,  
nina-nana, fli.  
Natë e zezë, e dendur  
na rrethon tani.

Na rrethojnë çadrat,  
hasmi na rrethon.  
Ti je si një lule  
varur mbi një hon.

Numërojnë plagët  
turqit nëpër terr.  
Dhe trupat e vvarë  
lumi poshtë i merr.

Po afrojnë topat  
turqit në hendek.  
Po nuk flënë rojet,  
përgojnë çdo shteg.

Kullat janë të larta,  
muret me qemer.  
Kryqëzojnë heshtat  
ushtarët në terr.»

---

*hasm-i* — armiku, këtu: turqit  
*terr-i* — errësirë

### Pyetje

- *Ku e dalloni shqetësimin e princeshës për vendin e saj, për njerëzit që qenë vvarë?*
- *Ç'mësuar për humbjet e ushtrisë turke?*
- *Cilën armë të fuqishme për atë kohë, përdorën turqit për të sulmuar kështjellën e pamposhtur?*

### XXIII

Po këngën pse e ndërpreu?  
Një alarm natën e vrau.  
Me thikë në mes e preu,  
në dy copa shpejt e ndau.

Ajo doli në dritare,  
natën në fytyrë e pa.  
Dikush thirri tek oborri:  
«Turqit hynë në kala.»

Një ulërimë,  
një hata  
vinte që poshtë:  
«Allah, allah.»

Turqit u sulën  
me jataganë.  
Ç'tmerr panë muret,  
e portat ç'panë!

Nën pishtarët  
e flakadajtë,  
armiqtë mbinin,  
nxinin si djajtë.

Në çdo oborr  
e çdo rruginë,  
shqiptarë e turq  
u vranë, u grinë.

Daullja binte,  
binte boria.  
Shpatat dhe thikët  
nxirrnin shkëndija.

---

*alarm-i* — lajmërim që të jemi gati për të përballuar një rrezik.  
*flakadan-i* — zjarr me flakë të madhe

### Ç'kuptoni me fjalët:

- Ajo doli në dritare,  
natën në fytyrë e pa.
- Shpatat e thikët  
nxirrnin shkëndija...?

### Pyetje e detyra

- Ç'cilësi e princesshës Argjiro dallohet në vargjet e para?
- Ku del se përleshja kësaj here u zhvillua trup me trup?
- Ku u zhvilluan këto përleshje të përgjakshme?
- Me ç'armë e sende u luftua?
- Duke përdorur disa mbiemra, tregoni si ishte përleshja.



## XXIV

Zbardhi dita. Ditë e zezë.  
Fortesë, e mjera fortesë,  
gjak e lyer, e përlyer,  
por akoma e pathyer,  
për të fundit herë u gdhive,  
me kullat qiejt përpive.

Po vazhdonte luftë e rreptë.

Vazhda gjaku nëpër mure,  
duke varur tatëpjetë,  
dukeshin posi flamurë.

Brokulliseshin përposh,  
leshaskuqur përgjithmonë,  
kokë të prera heronjsh,  
si diej që perëndojnë.

Por në kullën më të lartë  
një flamur po ngrihej ende.  
Në pëlhurë të tij të zjarrtë  
gjaku skuqte, shkaba rendte.  
Atje Argjiroja princeshë,  
e menduar, e pashpresë,  
kish dalë e shihte luftimin,  
një nga një ushtarët binin.

---

*me kullat qiejt përpive — kalaja është ndërtuar në vend të lartë.*

### **Ç'kuptoni me fjalët:**

- Në pëlhurë të tij të zjarrtë  
gjaku skuqte, shkaba rendte...?

### **Pyetje e detyra**

- *Pse poeti përdor fjalët: ditë e zezë? Për ç'ditë e ka fjalën ai?*
- *Ku del që janë bërë luftime shumë të ashpra? Lexoni vargjet.*
- *Ç'kuptoni me vargjet: «Por në kullën më të lartë një flamur po ngrihej ende»?*

## XXV

Natë e robërisë  
afion tani.  
Shkretëtirë përpara.  
Muzg edhe zi.

Robërinë, vogëlushe,  
ti nuk e di.  
Qetë nën zgjedhë  
ke parë ti?

Por, mendo të lidhur  
gjithë një popull,  
me brigje e fusha  
dhe qiell rrotull.

Të lidhur si njerëzit  
lulet, lumenjtë.  
Hedhur prangat mbi zogjtë,  
hedhur mbi retë.

Nën zgjedhë malet  
dy nga dy.  
Mbi pullaz troket breshëri:  
«Robëri, robëri».

## XXVI

Me litar e me zinxhirë  
përmbi muret gurënxirë,  
turqit ngjiteshin në kullë,  
përmes vdekjes hapnin udhë.

Midis tyre dhe Disdari  
rend e ikën si i marri.  
Sytë e skuqur ngre përpjetë,  
sheh Argjiron ballëzbetë,  
që mbi kullë rri e mjera,  
lahurinë i merr era.

Dhe ai, si qen i ndotë,  
që i leh hënës së plotë,  
sulet prapë në të përpjetë,  
të zbresë hënën nga retë.

Por tek sulej nëpër shkallë,  
princesha harkun e ngriti,  
një shigjetë mu në ballë  
si flamur zie i ngjiti.

U rrokullis tradhëtari  
në humnerë tatëpjetë.  
Dy-tri gurë pas i vanë.  
(Kaq ish zhurma e tij në jetë.)

Të shpërndarë mbi shkëmbinjtë  
po ngërdhesheshin florinjtë.



---

lahuri-a — shami koke e madhe, e hollë e me xhufka anëve

### Ç'kuptoni me fjalët:

- Përmes vdekjes hapnin udhë?

### Pyetje

- Ç'mjete përdorën armiqtë për t'u ngjitur në kështjellë?
- Pse qe vështirë të ngjiteshe?
- Në cilin varg flitet për vështirësinë?
- Ç'bëri Disdar tradhëtari kur pa Argjironë ballëzbetë në majë të kullës? Si përfundoi ai?
  - Shkrimtari ka përdorur dy krahasime për ta nxjerrë më mirë pabesinë e tradhëtarit. Gjejini ato dhe shkruajini:  
si \_\_\_\_\_  
si \_\_\_\_\_
  - Qëndrimi burror i Argjirosë na bën krenarë. Radhitni veti të grave shqiptare, që janë parë në luftë kundër armiqve të vendit tonë.
  - Si e ka çmuar dhe e çmon Partia forcën e gruas për Çlirimin e atdheut dhe lulëzimin e tij? (Bisedoni me prindët).



## XXVII

Dhe sytë e princeshës panë  
si të fundit roje ranë.  
Ajo mbeti krejt e vetme,  
yll në errësirë të netve.

Atëherë turqit përpjetë  
u vërsulën që të tërë.  
Kështu në mbrëmje hedh deti  
dallgët e zeza në rërë.

Duan ta zënë të gjallë,  
po a zihet ylli, vallë?

Princesha me djep në krahë  
u vërvit nga kulla poshtë...  
Dallëndyshet i ke parë  
kur mësojnë vjeshtës zogjtë?

Rrugën e parë në jetë  
me foshnjën bënte princesha.  
Në qiell të atdheut përjetë  
ajo mbeti e varur peshë.

Ajo bie e nuk po bie,  
një shami në hapësirë  
pezull mbi shekujt me hije  
si ëndërr e bardhë ka ngrirë.

---

vërvitem — sulem

### Ç'kuptoni me fjalët:

- Dhe sytë e princeshës panë  
si të fundit roje ranë...
- Duan ta zënë të gjallë  
po a zihet ylli vallë...?

### Pyetje e detyra

- Ku arrin kulmin trimëria dhe heroizmi i gruas shqiptare?
  - Me kë e krahason shkrimtari Argjironë?
  - Pse Argjiroja u hodh në humnerë bashkë me foshnjën?
- Ka pasur dhe raste të tjera në historinë e popullit tonë, ku

gratë, për të mos rënë në duart e armiqve, janë hedhur në greminë. Ç'tregon një gjë e tillë?

- Përmendni emra dëshmoresh apo heroinash të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.

- Nga cilat veti të popullit tonë u frymëzua shkrimtari Ismail Kadare për të shkruar poemën «Princesha Argjiro»?

- Pse duhet ta njohim historinë e lavdishme të popullit tonë? Si mund ta njohim? Tregoni mjetet dhe format e ndryshme.

- Ç'kujdes tregon Partia jonë për monumentet historike, si kështjellat etj?

## XXVIII

Mbi fortesë, në bedenë  
turqit të mahnitur mbenë.  
«O allah i lartë» — thanë  
të copëtohen kur i panë.

Rrotull malet oshëtinë,  
oshëtinë e bubullinë.  
Dhe shkëmbi ku u copëtua,  
thonë u drodh, u gjallërua  
dhe kujtoi ky shkëmb i bardhë  
se fëmija mbeti gjallë,  
dhe, që foshnjën të mëkojë,  
qumësht zuri të pikojë.

Se jetimëve që kanë lënë  
ata që në luftë kanë rënë  
dhe shkëmbinjtë u bëhen nënë.

---

*mëkoj (koj)* — ushqej foshnjën, i shtie ushqimin në gojë

### Pyetje dhe detyra

- *Pse u mahnitën turqit?*
- *Pjesëmarrja e natyrës në ngjarje e bën atë më të fuqishme. Lexoni vargjet ku del pjesëmarrja e natyrës, e cila rrit kështu krenarinë dhe dhembjen.*

## XXIX


U trishtove, vogëlushe,  
syri i bukur t'u përlot,  
për të bukurën princeshë,  
për foshnjën që s'u rrit dot.

Këto pìrgje mbajtën topa,  
duruan shpate dhe shqyt,  
që të vije ti në botë,  
që të thoshje «nënë» shqip.

Tani jepma dorën, vajzë,  
ja, mbaroi kjo histori.  
Nga të vjetrat fortesa  
do të dalim përsëri.

Dhe si shkallët e bodrumit  
shekujt do të ngjitem bashkë.  
Me bori e me dum-dume  
kohërat thonë: «mirupafshim!»

Ja largohen pìrgje, kulla,  
trokthe kuajsh, dimër i thatë.  
Dhe kalorësi tek udha  
humbi prapë nëpër natë.



XXX

Dolëm prapë në kohën tonë,  
Gjirokastrën për të parë.  
Muret me radhë qëndrojnë  
shirat gjakun kanë larë.

Ja shkëmbi ku ish copëtuar  
princesha flokëlëshuar,  
vetmitar qëndron tek udha,  
si një roje plak me rrudha.

Zbardhnin tej, lagjet me radhë,  
në këto mure e rrëtime,  
lidhur si balonë e bardhë  
shfaqet fëminija ime.

Horizont i madh, pa fund,  
mbi pirgjet e historisë  
Erë e viteve po tund  
balonën e fëminisë.

#### Pyetje dhe detyra rreth poemës

• Tregoni ngjarjen e poemës «Princesha Argjiro», duke u mbështetur në këto pika plani:

a. Njohja me Argjironë

b. Ardhja e turqve

c. Qëndrimi i vendosur i shqiptarëve

ç. Tradhëtia e Disdarit

• Cilët janë pjesëmarrësit e kësaj poeme?

• Flitni për vetitë e Argjirosë dhe të luftëtarëve shqiptarë.

• Cila pjesë e ngjarjes ju pëlqen më shumë? Për ç'gjë u shqetësuat, u gëzuat apo u hidhëruat?

• Gjeni dhe shkruani disa nga krahasimet që ka përdorur shkrimtari.

• Mësoni përmendsh pjesën që ju pëlqen më shumë dhe shkruajeni edhe në fletore.

• Tregoni pjesë të tjera ku vihet në dukje trimëria dhe heroizmi i gruas shqiptare në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare.

• Plotësoni me shkrim tabelën e mëposhtme për poemën e lexuar.

Titulli i librit: \_\_\_\_\_

Autori: \_\_\_\_\_

Pjesëmarrësit e poemës: \_\_\_\_\_